10142
12.11.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

KRYETARI

Lushnje, më 12/11/2025

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK

KËTU

"PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINE E LUSHNJËS DHE PENALITETET PËR KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE"

Te nderuar zotërinj keshilltarë!

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 date 17.12.2015 *"Per veteqeverisjen vendore"*; Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" me ndryshimet përkatëse, po ju prezantoj nivelin e taksave, tarifave dhe kundravajtjet administrative të Bashkisë Lushnje.

Unë në cilësinë e Kryetares së Bashkisë Lushnje, së bashku me strukturat administrative të Bashkisë, kemi përgatitur propozimin per sistemin e taksave, tarifave dhe kundravajtjet administrative që do të zbatojë Bashkia jonë duke filluar nga 1 Janar 2026 dhe propozojmë disa ndryshime kryesore krahasuar me vitin e mëparshëm.

Nisur nga kërkesa e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime SH.A e cila kërkon kërkon lidhjen e një akt marrëveshje dhe vendosjen e një komisioni mujor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore dhe familjare që mbledh si agjent tatimor për Bashkinë Lushnje dhe duke u bazuar në rëndësinë e këtij agjenti për realizimin e të ardhurave tona ju propozojmë një komision 5% e vlerës që kjo shoqëri do të mbledh në muaj për Bashkinë Lushnje, ku kushtet dhe afatet do të përcaktohen në një marrëveshje midis palëve.

Bazuar në udhëzimin nr 1 datë 10.09.2025 " Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave , për vitin 2025" ku çmimi për kosto ndërtimi është

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
LUSHNJË

Nr.10142/1 prot

Lushnje,më 12/11/2025

PROJEKT-VENDIM
Nr. 107 Datë 12/11/2025

"PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE. ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINE E LUSHNJËS DHE PENALITETET PËR KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE"

Këshilli i Bashkisë Lushnjë në mbledhjen e tij të datës së / /2025, bazuar në nenin 5 gërma "b",neni 9,20,22,23,26,27,28,32dhe 33 të Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar me Ligjin Nr. 181/2013, date 28.12.2013; Ligj Nr. 85/2014, date 17.07.2014; ligjit nr. 139/2015 date 17.12.2015 *"Per veteqeverisjen vendore"*, i ndryshuar, neni 9 pika 1.1 gërma "a" dhe "b",pika 1.3 gërma "b",neni 54 germa "f" dhe "k", Ligjin nr 9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar; ligjit nr. 107/2014, date 31.07.2014, "Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative"; ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin,transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar; Ligjit nr.9723 datë 03.05.2007"Per Regjistrimin e biznesit", i ndryshuar; neni 6 i Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore",Ligjit Nr.8378 dt 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikes së Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjit nr.44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; VKM 283, date 01.04.2015 **"**për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"i ndryshuar, VKM nr.132, datë 7.3.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës ' i ndryshuar',Ligjit Nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake", Ligjit nr.10 431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar,neni 31,32,dhe 33 të Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", neni 11, neni 12, neni 27, neni 35, neni 37 dhe neni 38, Ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, Vendimit nr. 99, datë 18.02.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", i ndryshuar,Udhëzimit Nr. 6 datë 11.04.2022"Për mjetet që përdoren për peshkimin

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al